REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË

Nr. 1760 Prot. Datë 27 / 06 / 2024

Lënda: Përcjellje njoftimi

BASHKIA MA
Zyra e Protokollit
Nr. 3142 Prot.
Date 01.07.24 Nenshkrimi

Bashkisë Maliq
Maliq

Njësive Administrative:
Maliq
Libonik
Gorë
Moglicë
Vreshtas
Pirg
Pojan

- SI IHP dt 01.07.2024

Në zbatim të Vendimit nr. 827 datë 30.09.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për miratimin e dokumentit të pronësisë së objekteve pa titull pronësie dhe të oborreve në përdorim*", Drejtoria Vendore e ASHK Korçë ka nisur trajtimin e aplikimeve për objekte të ndodhura në territorin e njësisë suaj. Gjatë shqyrtimit u konstatua se nga ana e disa poseduesve është paraqitur kërkesë para hyrjes në fuqi të Vendimit të sipërcituar. Bazuar në pikën 48 të Vendimit nr. 827 datë 30.09.2020 ku citohet se:

"*Për objektet pa titull dhe oborret në përdorim, për të cilat është paraqitur kërkesë përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe nuk janë përfunduar procedurat administrative, nuk është nevoja të riparaqitet kërkesë sipas modelit të këtij vendimi. Për këto raste, subjektit i njoftohet tarifa e shërbimit, nëse nuk është shlyer më parë ose nëse detyrimi aktual financiar për tarifën është më i madh. Procedurat administrative vijojnë vetëm pas shlyerjes së tarifës dhe ajo është e pakthyeshme në rast refuzimi të kërkesës sipas kritereve të këtij vendimi.*"

Si dhe në zbatim të neneve 5 dhe 6, konkretisht:

5. "Kur procedura nis me kërkesë të subjektit, ai duhet ta paraqesë aplikimin on-line nëpërmjet platformës unike qeveritare e-albania dhe të shlyejë tarifën e shërbimit për procedurën administrative..."

6. "Tarifa e shërbimit për procedurën administrative të miratimit të dokumentit të pronësisë është 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe shlyhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për kalimin e pronësisë dhe është e pakthyeshme edhe në rast rrëzimi të kërkesës nga ASHK-ja..."

Rr "1 Maji", Lgj. 18, Korçë
http:// www.ashk.gov.al
Tel: +355 82244642
Faks: +3558224464

157

Në mënyrë që DVASHK Korçë të vazhdojë me proçedurën administrative të trajtimit të aplikimeve, kërkojmë nga ana juaj:

- Të njoftohen, nëpërmjet afishimit në ambiente publike, banorët e njësisë të cilët kanë kryer aplikime para datës 30.09.2020 (sipas VKM Nr. 442/2018), të shlyejnë tarifën e shërbimit për proçedurën administrative.

- Të njoftohen, nëpërmjet afishimit në ambiente publike, banorët e njësisë të cilët nuk kanë dokumentacion pronësi për objektet me funksion banimi/oborret në përdorim para datës 10.08.1991 të aplikojnë pranë portalit qeveritar e-albania në rubrikën " **Kërkesë për kalimin e pronësisë të objektit pa titull/truallit funksional/oborrit në përdorim**" në mënyrë që Drejtoria e ASHK Korçë të fillojë proçedurën administrative.

Pas plotësimit të dokumentacionit të mësipërm do të vijohet me trajtimin e mëtejshëm të proçedurave administrative për trajtimin e aplikimeve në zbatim të VKM-së 827/2020.

- Bashkangjitur po ju përcjellim njoftimin

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

DREJTORI

Stavri Mushka

Stavri Mushka

Digitally signed by Stavri Mushka
Date: 2024.06.26 10:52:06 +02'00'

NJOFTIM

Njoftohen banorët e njësisë të cilët nuk kanë dokumentacion pronësie për objektet me funksion banimi/oborret në përdorim para datës 10.08.1991 të aplikojnë pranë portalit qeveritar e-albania në rubrikën "**Kërkesë për kalimin e pronësisë të objektit pa titull/truallit funksional/oborrit në përdorim**" në mënyrë që Drejtoria e ASHK Korçë të fillojë proçedurën administrative.

Njoftohen banorët e njësisë të cilët kanë kryer aplikime para datës 30.09.2020 (sipas VKM Nr. 442/2018), të shlyejnë tarifën e shërbimit për proçedurën administrative. *(Tarifa e shërbimit për procedurën administrative të miratimit të dokumentit të pronësisë është 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe shlyhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për kalimin e pronësisë dhe është e pakthyeshme edhe në rast rrëzimi të kërkesës nga ASHK-ja).*

Rr "1 Maji", Lgj. 18, Korçë
http:// www.ashk.gov.al
Tel: +355 82244642
Faks: +3558224464